



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

E K S T R A K T

Nga procesverbali i mbledhjes së 13-të të Kuvendit të Komunës së Lipjanit mbajtur, më 27. 11. 2018, në sallën e Kuvendit me fillim në ora 10⁰⁰

Në mbledhje prezentuan:

1. Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit
2. Mehmetali Krasniqi, anëtar
3. Nehat Tërpeza, anëtar
4. Fadil Sopa, anëtar
5. Hyra Bytyçi, anëtare
6. Anila Reçica, anëtare
7. Ramadush Tasholli, anëtar
8. Naim Jahiri, anëtar
9. Naim Stullca, anëtar
10. Majlinda Sylejmani, anëtare
11. Lulzim Rrustemi, anëtar
12. Ramiz Qeriqi, anëtar
13. Argjent Tasholli, anëtar
14. Nazmi Krasniqi, anëtar
15. Lumturije Bytyqi-Hasani, anëtare
16. Egzona Bytyqi, anëtare
17. Selatin Retkoceri, anëtar
18. Shkelzen Bislimi, anëtar
19. Albulena Kelmendi, anëtare
20. Afrim Miftari, anëtar
21. Hajdin Bytyqi, anëtar
22. Safete Amerllahu, anëtare
23. Bashkim Budakova, anëtar
24. Ukë Kryeziu, anëtar
25. Ganimete Qeriqi, anëtare
26. Manush Shamolli, anëtar
27. Egzona Fazliu, anëtare
28. Arben Salihu, anëtar
29. Fehmi Rexhepi, anëtar

Të tjerë prezent:

1. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës
2. Fauz Xhemajli, nënkryetar i Komunës
3. Lulzim Qerimi, nënkryetar i Komunës për komunitete
4. Avni Olluri, drejtor i DA
5. Rasim Hasani, drejtor i DA

6. Latif Ramadani, drejtor i DBF-së
7. Nazim Gashi, drejtor i DMSH,
8. Imer Rrustemi, drejtor i DI,
9. Bekim Shabani, drejtor i DRSK
10. Sefer Tasholli, drejtor i DGJK
11. Ilir Tasholli, drejtor i DSHP
12. Shefqet Amerllahu, drejtor i DBPZHR
13. Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS
14. Vlora Krasniqi, zyrtare ligjore
15. Kimete Jashanica, OSBE-së
16. Bekim Krasniqi, OJQ"YAHR"
17. Bukuriye Zejnullahu, zyra e informimit
18. Besart Troshupa, zyra e informimit
19. Përfaqësues të mediave dhe
20. Numër i konsideruar i qytetarëve

Procesverbalin nga kjo mbledhje e mbajti **Behar Aliu**.

Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, pas konstatimit se në mbledhje prezentojnë 28 anëtarët nga gjithsej 31 anëtarë të Kuvendit hapi mbledhjen duke përshëndetur të pranishmit.

Pastaj tha se rendin e ditës së bashku me material e keni marrë dhe në vazhdim lexoi rendin e ditës së propozuar.

REND DITE

1. Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit
2. Propozim Rregullorë për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019
3. Propozim Vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan
4. Propozim Rregullorë për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.
5. Propozim Vendim për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit
6. Informatë pune nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën Janar-Shtator 2018
7. Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve

Daut Azemi, Kryesues i kuvendit pyeti se a ka dikush vërejtje rreth rendit të ditës.

Bekim Shabani, drejtor DKRS, tha se kërkoj të hiqet pika e tretë e rendit të ditës, propozim vendim për dhënien e pëlqimit për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për shkak të një gabimi teknik në kërkesën e tyre. Pasi që presim që t'i përmbledhim të gjitha rastet me një vendim të vetëm dhe shpresojmë që nga janari i vitit 2019 të hynë në fuqi Rregullorja e re për varrezat.

Pastaj Kryesuesi pyeti se kush është për heqjen e kësaj pike nga rendi i ditës dhe me të gjitha votat prezente heqet kjo pikë e rendit të ditës. Ne vazhdim Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës ku me të gjitha votat prezent kaloi.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, pasi që jemi në festat e nëntorit kisha propozu të vendoset një simbol i Shqiponjës te rrethrotullimi afër shtëpisë së kulturës. Çështja e dytë kur do të formohen komitetet jo obligative dhe te rruga Dobratin-Silovi a është dashtë të jenë dy shtresa të asfaltit sipas kontratës.

Ganimete Qeriqi, unë e kam bërë një kërkesë përmes arkives që të jetë si pikë e rendit të ditës por mbes me shpresë që në séancën e ardhshme të vijë në Kuvend. Kërkesë e një prindi të një fëmiju me nevoja të veçanta. Është kërkesë nga OJQ “APFAKKOS” prindi dhe fëmiju, ku kanë disa kërkesa si që janë: sigurimi i një parcele, një lokal ku mund t'i zhvillojnë trajnimet e tyre, etj. me të cilën jeni të njoftuar edhe ju asambleistë të nderuar të cilën u`a kam dërguar në ema-il. Çështja tjetër ka të bëjë me kërkesën e një qytetari të fshatit Krojmir ku ka një pyetje për Kryetarin dhe z.Tashollin pse rruga prej “Halil Meta” deri te “14 dhjetor” nuk është asfaltuar, ku në atë lagje e kanë kapë të gjithë pushkën në luftë po ashtu ka qenë edhe shtabi i UÇK-së si dhe ka pasur dëshmorë. Po ashtu në fshatin Rufc të vjetër është një lagje e pa ndriçueshme.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, ju kisha lutë të fokusoheni në pyetje mos të lëshohemi fortë në histori ju i bëni pytjet ekzekutivi përgjigjet.

Selatin Retkoceri, tha se po vërehen disa punë në ambient, deponi mbeturina, pyllzime të fshatrave. Është mirë të vazhdohet gjithkund kur ka mundësi për pyllëzim, gjelbrim edhe drunjë dekorativ edhe në vende tjera e jo vetëm në Lipjan.

Kësaj here do të ndalem në fshatin Llugaxhi e di se ka qenë një projekt për rregullimin e hapsirave të fshatit të cilat për momintin janë të dezorganizuar pa kurfarë kuptimi. Kjo do të mund të bëhej nëse rruga do të zhvendosej që shkon rreth shkollës, kjo rrugë nuk është më e gjatë se një kilometër dhe do t'i eliminonte disa probleme në fshat. Është rasti i Xhamisë së fshatit mu për këto shkaqe nuk po ndërtohet, sepse çdo njëri që ka këtë pronë para shtëpisë po konsideron se është e tij. Po të heqen këto rrugë lokale do ta kem një hapësirë të veçant pyllzimi. Në vazhdim tha se është mirë që edhe në vende tjera ku ka hapsira të tilla të vazhdohet njëjtë. Në Banullë është mirë, por duhet vazhduar edhe në vende të tjera ku ka hapsira të tilla. Është mirë të fillohet me rrafshimin por edhe pyllëzimin e dijmë se është kosto e lartë por mundësisht me një kosto të lirë të vehen rrethojat pasi ato mund të dëmtohen. Inkurajojm Kryetarin dhe departamentet të dalin edhe në fshatra e jo vetëm në qytet.

Lumturije Bytyqi-Hasani, unë kam një pyetje për drejtorin e inspektoratit, kohëve të fundit Ministria e tregëtisë dhe industrisë e ka lëshuar një urdhëresë për produktet që u referohet me Kosovë e Metohi, Kosova UNMIK, rezoluta 12-44, çfarë hapa keni marr ju drejtor a keni dalë me inspektu tregun nëse keni gjetur kësi produkte a i keni konfisku.

Çështja e dytë është për një sportiste në shkollën “Ismajl Luma” e cila është Medina Seferi dhe bënë gara në Prishtinë e cila po korrë rezultate të mira në turnire të ndryshme ndërkombëtare ku ka marrë pjesë në Shkodër dhe Nikshiq ku ka qenë e para është mirë ta ketë ndihmën institucionale të komunës. Me që jemi në fund vit dhe është bërë traditë që komuna zakonisht ndajnë mirënjohje propozoj që edhe Medinën ta fus në listën e atyre dhe t'i japim një përkrahje dhe vullnet.

Egzona Bytyqi, desha të informohem se sa po zbatohet marrëveshja e MSA-së ndryshe si që quhet stabilizim asociimit dhe si qëndrojmë ne si komunë në realizimin e rekomandimeve. Çështje tjetër është alarmimi i produkteve të kategorisë lodër që analiza e tyre ka dal të jetë e dëmshme dhe po më intereson a ka marrë drejtoria përkatëse masa në këtë drejtim.

Albulena Kelmendi, me që jemi në vigjilje të festës së 28 nëntorit po e shfrytëzoj rastin me ua uru këtë festë. Kemi një ankesë nga qytetarët e fshatit Hallaqi i Vogël lidhur me ndriqimin. Kërkojmë nga drejtoria përkatëse të ndërmarr diçka lidhur me ndriqim. Pasi që ajo pjesë gjendet afër burgut të Lipjanit dhe këta banor ndihen të frikësuar. Ku para një kohe janë arratisur dy persona nga ky burg kanë qenë në panik këta banor. Arsyeja që nuk ka pas ndriçim. Pastaj pyeti drejtorin e arsimit, kam një informatë për nxënësit e shkollës së Ribarit të Madh ku këta nxënës janë privuar nga lënda e gjuhës Gjermane për tre muaj, po ashtu edhe për shkollën fillore “Migjeni në Rufc. Deshta të dije të vërtetën se a ka ndodhur dhe pse ka ndodhur, a është punësuar arsimtari përkatës. Çështje tjetër që po e ngris është për qytetarët e komunës së Lipjanit dhe të fshatrave që po vazhdojnë që po kanë problem me ujë, kisha dashtë me kërku që drejtori i ujësjellësit me perpilu një raport dhe me na tregu se çka po ndodh dhe me bo ni strategji si me i sanu këto probleme me ujë.

Bashkim Budakova, kam një kërkesë të banorëve të fshatit Kojskë që i drejtohet organeve kompetente që të intervenohet në lumin Sitnica pikërisht tek ura që lidh dy fshatra Kojskë dhe Topliqan pasi nga mbeturinat është bërë i pa kalushëm për banorët e fshatit, po ashtu gjatë stinës së verës ka pasur dalje nga shtrati i lumit që ka shkaktuar vërshime dhe ka bërë dëme të mëdha të kullosave të fshatit Kojskë dhe Topliqan dhe kërkohet nga organet kompetente të intervenohet në pastrimin e lumit pasi është koha e dimrit dhe shtrati i lumit është i mbyllur. Deshta të ngris edhe një qështje rreth ujësjellësit të fshatit Rubovc, Rubovc i Vogël dhe fshatit Kojskë se a është intervenuar të sanohet problemi gjatë hapjes së rrjetit të kanalizimit dëmi që është bërë nga punëkryerësi pos që nuk kemi pas as një përgjigje kemi problem edhe me funizimin me ujë të pijshëm. Kërkesat e këtyre banorëve janë që të funksionalizohet rrjeti i ujësjellësit. Kërkoj një përgjigje a është ndërmarrë masa dhe nëse nuk është ndërmarrë diçka rreth ujsjellsit pse nuk është ndërmarrë arsyen.

Argjend Tasholli, kam disa çështje për ekzekutivin po filloj me lagjen "Arif Aliu" dhe "Ilirida" ku është një rrugë shumë e frekuentuar dhe ka një rrezik nga qenët endacak dhe kjo rrugë është pa ndriqim ku është rrezik gjatë mbrëmjes për të kaluar. Unë si asambleist kërkoj që të merrni hapa në këtë drejtim dhe të ndriçohet kjo lagje. Një shqetësim është për të rinjtë e Lipjanit, koncertet me rastin e festave të nëntorit. Kam një kërkesë nga një i ri nga Lipjani i cili drejtohet me një letër, unë jam Fahredin Bytyqi, e kam një pyetje për kryetarin, pse aktivitetet i mbani me asamble jashtë komunës, ndërsa të rinjtë e Lipjanit sillen rrugëve.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, tha se së pari po përgjigjem për kërkesat individuale Lipjani ka dikun 60 mijë banorë, por është mirë me i piketu problemet e përgjithëshme e jo problemet individuale. Sa i përket letrës së një ansambel - valltari nga komuna e Lipjanit që është drejtuar komunës në këtë letër i janë dhënë projekte të caktuara disa herë, por janë disa procedura, rregulla që duhet përcillen dhe që caktojnë konkurrencën e lirë. Ne nuk mund t'i paguajmë ati sa kërkon. Është konkurrenca e lirë e cila e cakton çmimin e tregut.

Sa i përket disa ideve për ndriçimin e iks rrugëve, lagjeve investimeve kapitale është një periudhë tre mujore ku janë bërë dëgjimet buxhetore dhe buxheti është i aprovuar dihet se çka të bëhet për vitin e ardhshëm, ne buxhetin nuk mundemi me e ndryshu.

Të gjitha çështjet janë me rëndësi por më me rëndësi është për mu është çështja e ujësjellësit që u ngrit. Edhe në seancën e kaluar z. kryesues kam kërkuar që të komunikohet me drejtorin e ujësjellësit që në seancën e parë apo në janar të na raportoj për çështjen e ujësjellësit.

Sa i përket problemit të Sitnicës e dije se është lidhur një kontratë me një kompani nga MPH. Por problemi është me një urë e cila është e ngushtë po mbyllet e po ju shkakton telashe banorëve që po qarkullojnë në dy anët e lumit. Jemi në pritje të fillimit të punimeve nga MPH, për hapjen, zgjerimin e lumit Sitnica që kanë të bëjnë me kolektorin e ujërave të zeza në të dy anët e lumit.

Për hapsirat publike që e përmendi Selatini po kemi fillu dikun ku kemi pasur mundësi, në prioritet duhet të jetë në vitin e ardhshëm, por problem është mirëmbajtja e tyre pasi këto bëhen nga buxheti për mallra dhe shërbime që nuk po na lejohet nga Ministria pasi që ajo e cakton tavanin buxhetor të kemi rritje. Do të fillojmë me bashkë participim në të ardhmen me organizata të ndryshme për zgjerimin dhe gjelbrimin, pyllzimin e hapsirave publike. E di se është bërë një punë rreth lumit Banullë, Gadime, Dobrajë, Slllovi edhe në Lipjan pak me disa hapsira publike.

Sa i përket idesë për Shqiponje Lipjani e ka një Shqiponjë e ajo është Adem Jashari.

Sa i përket komiteteve jo obligative mund të formohën por është problem që Ministria nuk po lejon pagesat e tyre. Këto komitete Kuvendi mund t'i formen por për shkak të pagesave nuk po kanë efekt.

Sa i përket rrugës së Slllovisë për dy shtresa po ka qenë e tillë e kontraktume dhe ne ende kemi një borxh për atë rrugë por edhe kompania ka problem të funksionimit, kontrata është e lidhur për shtresën e dytë, kompania ende nuk e ka vazhduar punën, herët a vonë do të duhej të kryhet kjo shtresë. Pat edhe pyetje për rrugët në Krojmir dhe disa fshatrave tjera por nuk janë rrugë të fshatrave por janë disa rrugë të lagjeve. Në të ardhmen do të bëjmë evidentimin e të

gjitha rrugëve dhe të gjitha fshatrave që janë të pa shtruara dhe sakësisht e dijmë se a janë prona private apo publike.

Sa i përket pyetjes për mallëra dhe produktet serbe tha për këtë mund t'ju njoftoj drejtori i inspektoratit.

Sa i përket Medina Seferit është anëtare e një klubit të Prishtinës e jo nga Lipjani dhe këto klube janë të rexhistruara si OJQ dhe ne nuk mund t'i ndihmojmë si komunë. Ne nuk mund t'i japim subvencione e për mirënjohje po.

Sa i përket MSA-së, MSA-ja është çshtje teknike janë disa standarde dhe formular që vijnë nëpër departamente të caktuara të komunës, ne e kemi një grup që merret me vlerësimin e këtyre kërkesave dhe ne nuk kemi pas obligim që komuna e Lipjanit i ka mbetur borxh dhe zakonisht i kemi kry me shpejtësi dhe me kohë.

Imer Rustemi, lidhur me pyetjen e Lumturijes, jemi në kontakte të vazhdueshme me MTI, ATK-së, lidhur me produktet e Serbisë inspektoriat i ka dalë në të gjitha lokalet t'i njoftoi lidhur me produktet që janë të ndaluara. Me Ligj është e qartë dhe përcaktuar që nuk e kanë mbishkrimin e shtetit. Në bazë të urdhresës që e kemi marrur nga Ministria kemi dalur në teren dhe kemi njoftuar të gjitha lokalet që t'i largojnë këto produkte.

Lumturije Bytyqi-Hasani, na e dijmë urdhëresa nga Ministria është marrë me 19 nëtor dhe ju e dini që e keni kryer aksionin, por është mirë me i njoftua qytetarët përmes Web faqes apo medijave.

Egzona Bytyqi, pyeti për çështjen e lodrave të rrezikshme?

Sa i përket këtyre lodrave MTI-ja e një plan të vaçant edhe për lodrat por nuk kemi një hapsirë ku t'i vendosim këtë do ta bëjmë kordinim me MTI-në dhe inspektoriatin komunal.

Lulzim Rustemi, unë i kam dy pyetje për ekzekutivin për rrugën katër korsi Lipjan-Banullë, rrethrotullimi te kryqi, a kemi diçka të re. Dhe e dyta për zonën industrial në Kërçev deri ku kemi mbërri dhe a jemi të gatshëm për tregun në atë zonë.

Ramiz Qeriqi, ju uroj festën e nëntorit, festën e Flamurit të gjithë atyre që e ndini veten shqipëtarë. Kam t'i ngris disa çështje te sheshi "Adem Jashari" a është bërë pranimi teknik a po presim deri sa të priset krejt. Te pallati që është te sheshi ju ka shtua një rrugë a është kalua nëpër procedura ajo rrugë, po dua me pyet se a është pyet dikush apo jo. Në Shtepinë e shëndetit po akuzohet një doktor me aferë seksuale a është ndërmarrë ndonjë masë ndaj tij.

Argjend Tasholli, unë nuk e njoh Fahredin Bytyqin e dijë që është me një ansambel, por kam do pyetje për Kryetarin a ka ansambel komuna e Lipjanit, kush e mban përgjegjësinë për krijimin e tyre. Ne kemi shumë të rinjë të cilët merren me këtë aktivitet t'i stimulojmë me mjete që ata t'i kemi pa pagesë në të ardhmen si në komuna tjera.

Albulena Kelmendi, tema për ndriçim që e ngrita për një fshat në komunën e Lipjanit është një fshat që gjendet pran burgut dhe duhet të jetë në prioritet ndriçimi për shkak se është afër burgut. Po ashtu nuk m'u dha informatë për arsimtarin e Gjermanishtes në fshatin Ribar i Madh dhe Rufc.

Sa i përket pikës së tret me që kjo pikë u hoq nga rendi i ditës unë në KPF kam kërkuar nga drejtorati përkatës me siguru raport nga BIK-u për parat, procedurat që janë ndjek për parat që janë marrë nga komuna për periudhën Janar-Nëntor.

Rasim Hasani, sa i përket arsimtarit të gjuhës Gjermane kemi pasur sfid me angazhu me perpilu një orar të caktuar. Për shkak të orëve që është dashtë me arritur 20 orë në javë. Kemi shpall konkursin janë panuar dhe nuk kanë ardhur. Tash e kemi angazhuar një arsimtar për një pjesë të shkollave.

Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës, sa i përket pyetjes së Argjendit se a ka rini që merret me aktivitete kulturore në komunën tonë. Po ka dhe ju ftoj që santë në ora 7 në mbrëmje të vini në Magurë me pa aktivitetin e rinisë së atij regjioni për festën e 28 Nëntorit.

Sa i përket ansambleve që komuna me pasur punëtorë të vetë të përhershëm nuk ka vi buxhetore. Këto ansamble janë të regjistruara si OJQ në Ministrinë relevante.

Sheshi rrugët janë procedura ligjore, disiplina në punë është përgjegjësi individuale e çdo puëtori që then rregullat gjatë dhe pas orarit. Organet e administratës kanë për detyrë në bazë

të një vendimi të prokurorisë e ka suspendu nga puna sikur edhe më parë po ashtu edhe të apostrofuarin në fjalë.

Dy çështje të rrethrotullimit në kryq të Lipjanit që ngriti Luli me interes publik këtë çështje se a humbin mjetet po ju përgjigjem nuk humbin se ato i ka pasur Ministria e jo komuna. Para do dite e kemi pasur Kryeministrin në takim për t'i shtyer këto procese. Ka një kontrat të lidhur mjetet buxhetore kanë qenë. Në buxhetin e Kosovës për komunën e Lipjanit në këtë vit nuk ka asnjë projekt këtë mund ta gjeni në veb-sajtin e Qeverisë.

Sa i përket asaj rrugë që me të drejtë e ngriti Luli këtë çështje është të hjek ky projekt dhe unë kam reagu dhe prap do të reagoj.

Sa i përket zonës ekonomike të Kërçevës nuk na i kanë financu edhe këtë vit.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth pyetjeve parlamentare u kalua në punë sipas pikës së parë.

I

Aprovimi i ekstraktit nga mbledhja e 12-të e Kuvendit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, pyeti anëtarët se a ka dikush vërejtje apo plotësime në ekstraktin të cilin e keni marrë.

Ramiz Qeriqi, kam vërejtje në faqe 5 kam thënë deri sa na i kemi mjete ajo kryesia është dashtë me pagu borxhin, po ashtu në faqe 7 unë e kam përmend me emër Shukri Bujen bile ja kum përmend edhe emrin e babës Gani, atë që e them dua të ma shkruani pavarisist atë qysh e them nuk ka nevojë me më kursy asnjëherë se e kam thënë me plot vetëdije. Po ashtu kam thënë në këtë pikë do të jem pa parti nuk ma ke shenu.

Meqë vërejtje të tjera nuk pati Kryesuesi vuri në votim ekstraktin nga procesverbali i mbledhjes së 12-te dhe pas votimit konstatoi se Kuvendi me 25 votat për,

Aprovoi

Ekstraktin nga mbledhja e 12-të e Kuvendit me vërejtjen e Ramiz Qiriqit

Shtesë: Ekstrakti.

II

Propozim Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019

Lidhur me këtë pikë Kryesuesi i Kuvendit, Daut Azemi, i dha fjalën Latif Ramadanit, drejtor i DBF-se, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i Rregullores.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Lulzim Rustemi, para vetes kemi një Rregullore që aprovohet çdo fund vitit, pjesa e parë është e njëjtë me vitet e kaluara. Pyetjet të cilat i kam janë për pronat të cilat nuk janë përfshi a do të fillojnë m'u tatimu prej vitin 2019 sepse Ligji ka hy në fuqi tash në vitin 2018. Tash to të kemi tatim edhe për oborre, livadhe, kullosa, kjo Rregullore a ka pasur nevojë të shkoj në dëgjim publik për qytetarët. Kishte me qenë mirë me na i dhënë një shembull konkret sa do të kushtoj çmimi nëpër zona. Ku për qytetarët përveq tatimeve tjera i shtohet edhe kjo dhe sa do të jetë e përbalueshme për qytetarët kjo. Po ashtu tatim do të paguhet edhe për ahër, kotec, shupa etj. Dhe kisha dashtë me ditë me një shembull konkret qytetari në vitin e ardhshëm sa do të ngarkohet.

Hyra Bytyçi, ne si grup parlamentar i LDK dhe PD-së konsiderojmë se Rregullorja është në harmonizim të plotë me Ligjin për tatimin në pronë. Risi e kësaj Rregullore krahas Rregullores së vitit të kaluar është që tani për herë të parë po tatimohen të gjitha kategoritë e zonave të njësive kadastrale në Komunën e Lipjanit. Ne vlerësojmë se tatimi në pronë është obligim i çdo qytetari, gjithashtu mendojmë se komuna ka vepruar drejtë duke caktuar norma tatimore minimale sipas dispozitave ligjore. Shpresojmë që me këtë Rregullore në të

ardhmen mund të rregullohen edhe shumë çështje tjera pronësore të cilat do të evidentohen gjatë procesit të ekzekutimit të pagesave nga qytetarët. Mirëpo ajo çka është me rëndësi që tokat bujqësore janë të përjashtuara nga tatimi dhe shpresojmë që do të jetë stimulim për zhvillimin e bujqësisë. Ne vlerësojmë se tatimi në pronën e paluajtëshme do të ndikon pozitivisht në rritjen e të hyrave nga tatimi. Është mirë të gjithë akterët e involvuar në këtë proces të bashkëpunojnë duke i informuar dhe ndihmuar qytetarët për rregullimin e qështjeve pronësore ashtu siqë është vepruar para dy viteve në komunën e Lipjanit me pilot projektin e realizuar në 6 zona nga Angjensia Kadastrale.

Latif Ramadani, po sipas nenit 10 të Ligjit kultura bujqësore nuk do të ketë tatim.

Sa i përket dëgjimeve ka pasur dëgjime nga ekspert të cilët janë marrë me këtë çështje, kjo është kompetencë e nivelit qendror ku ata i caktojnë ekspert edhe zonat, ndërsa sa do të zbatohet do të shohim.

Shemsi Azemi, sa i përket dëgjimeve publike qysh prej vitit 2017 ka qenë njoftimi i publikuar në web faqen e komunës po edhe në lokalitetet e ndryshme, po ashtu edhe në zyrën e tatimit në pronë ka qenë e vendosur harta me të gjitha zonat. Për caktimin e vlerës tatimore komuna ka qenë vetëm vëzhguese, ndërsa departamenti i tatimit në pronë dhe një grup i ekspertëve e kanë caktuar vlerën.

Lulzim Rustemi, pyeti te tokat bujqësore p.sh. Në janar-shkurt sipas nenit 10 kur e dijmë se cilat prona nuk tatimohen.

Shemsi Azemi, të gjitha pronat bujqësore të punueshme nuk tatimohen sipas Ligjit.

Lumturije Bytyqi-Hasani, deshta me pyet për faturat që do të ju dërgohen qytetarëve, a do të dërgohen veç e veç apo të gjitha në një fakturë dhe a do të kushtëzohen për regjistrimin e automjeteve.

Shemsi Azemi, është tu lansu një projekt ku të gjitha faturat do të bëhet pagesa.

Ramiz Qeriqi, po ju pyes se a e parasheh kjo Rregullore faljen e ndonjë kategorie siqë janë: rastet sociale, veteranët e UÇK-se etj.

Latif Ramadani, Ligji nuk e parasheh faljen e këtyre kategorive.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 28 votat për aprovoi këtë:

Rregullore për tatimin mbi pronën e paluajtshme për vitin 2019

Kryesuesi tha se pasi që pika e tretë e rendit të ditës hiqet kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës.

IV

Propozim Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Ramiz Qeriqi, është një Rregullore që është kërkuar kaqherë është një Rregullore e mirë ku po përfshihen të gjitha kategoritë dhe ju falenderoj shumë.

Shkelzen Bislimi, është një Rregullore shumë e mirë e punuar mirë por kam disa pyetje: a do të jenë procedurat administrative të vështira në praktikë dhe a do të ishte e mundur të ndalohet varrosja e kufomave në oborret e Xhamisë. A do të mund të kontraktohet një kompani për mirëmbajtjen e varrezave në të gjitha fshatrat.

Hyra Bytyçi, kjo Rregullore po shihet se është bërë në mënyrë profesionale për varrezat, por kam dy pyetje: a keni marrë propozime konkrete nga Bashkësit fetare dhe pyetja e dytë sa keni parapa koston e shpenzimeve.

Egzona Bytyqi, kjo Rregullore është për vlerësuar por e kam një mini vërejtje te neni 12 te zyra e Kryetarit te afati 30 ditor i paraparë a ka mundësi të zvoglohet për ato familje që janë të varfëra që janë me ndihmë sociale që në javën e parë t'i ipet shuma 50%.

Lulzim Rrustemi, është një Rregullore një hap para karshi kërkesave që kemi pasur për shfrytëzimin e paras publike. Por i kam pyetje për dy nene, te neni 13 për shpenzimet e varrimit. Po na kemi një dilemë nga qytetarët çka përfshihet në shumën 170€. Për shembull a mundet me u marrë fatur për hapjen e varrit, a mundet me marrë faturë për dërrasa. A ka institucion valid që i lëshon faturat. Është mirë me u detajizu shpenzimet brenda 170€. Është mirë që një kompani profesionale me u marrë me këtë punë që e lëshon faturën në mënyrë të rregullt. Sa i përket shumës 110€ që ka qenë e tash është 170€ këtu duhet një sqarim shtesë sepse 110€ janë shpenzime të varrimit ndërsa 60€ është shuma që mbetet për rite fetare. Te neni 15 për mirëmbajtjen e varrezave, tash organi komunal apo kompania po ngarkohet për mirëmbajtjen e lapidarëve, varrezave të dëshmorëve. Është mirë që varrezat e dëshmorëve ta kenë një trajtim të veçantë mirëpo edhe për varrezat e fshatrave nëse kemi një buxhet më të madhë është mirë të mos bëhen dallime. Te mirëmbajtja e varrezave në përgjithësi duhet të jetë një datalizim qka nënkupton. Për ndryshe Rregullorja është e avansume dhe ne do ta votojmë ashtu siqë është.

Avni Olluri, para se të përgjigjem në pyetjet tuaja duhet të falenderoj komisionin për punën që e kemi bërë që na ka marrë diku 4 muaj kohë. Në vazhdim tha se në pyetjen e Lulit çka merrë qytetari me 170€. Me këtë shumë qytetari kryen të gjitha shërbimet e riteve fetare ditën kur bëhet varrosja. Nga kjo shumë 110€ janë të gjitha shpenzimet plus 60€ janë për ritet fetare si që është te Bashkësia Islame shpenzimet e hoxhes. Sa i përket mirëmbajtjes së varrezave të qytetit dhe varreza të veçanta e kemi parapa pasi është qytet dhe janë më të dukshme janë të rëndësishme të veçant. E për varrezat të fshatrave kemi mungesë të buxhetit. Por në një të ardhme në rritjen e buxhetit do të mirëmbahen edhe varrezat e fshatrave. Sa i përket pyetjes së Shkelzenit se a do të jenë procedurat e vështira. Ne kemi shku në procedura të shkurtura. Në fillim ato janë faturat, çertifikata e vdekjes, dhe kopja e letërnjoftimit dhe gjirrollogarin bankiare të paraqitësit të kërkesës. Sa i përket pyetjes për varrimin në oborrin e Xhamisë kjo në bazë të Rregullores tregon se cilat janë varrezat e fshatit në bazë të vendimit të Kuvendit. Po kemi marrë edhe mbështetjen nga përfaqësuesit e Bashkësive fetare. Janë të pajtueshëm me formën të cilën po shkojmë.

Nehat Tërpeza, i falenderoj të gjithë akterët për këtë Rregullore por kam një pyetje a ka mundësi të hiqen faturat të bëhet me ribursim.

Ramiz Qeriqi, edhe unë pajtohem me Nehatin por jo të grumbullohen faturat, po është mirë me pas çertifikatën e vdekjes të nënshkruar nga hoxha ja prifti, kur dihet se na qytetarët i çelim varret vet e pse me detyru qytetarin me na pru faturë të rrejshme.

Bashkim Budakova, isha kyq te neni 15 të Rregullores te mirëmbajtja e varrezave ku kisha pasur një propozim të ketë një kompani për mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra pasi që është një gjendje jo e mirë. Ne si grup parlamentar e përkrahim këtë Rregullore.

Nazmi Krasniqi, unë mendoj që ka me pas probleme rreth grumbullimit të faturave nga qytetarët ku pajtohem edhe unë me Luanin ndoshta qytetarët kanë me qenë të detyruar me marrë një faturë të rrejshme. Ndoshta ka pasur ndonjë mundësi më të mirë për me i lehtësu procedurat.

Arben Salihu, t'u e marrë parasysh nga praktika e përgjithshme dihet se qytetarët janë drejtuar ose në Xhami ose në Kishë, nuk po e shoh të arsyeshme të hiqet fatura pasi që ndonjë rast mund të vdes këtu e të varroset diku tjetër. Nëse qytetarët shprehen se vetë po e hapin varrin ata mund të marrin faturën vetëm për shërbimet që janë kryer dhe unë nuk po e shoh të arsyeshme me u heq faturat.

Albulena Kelmendi, me sa po e shoh unë shuma maksimale është 170€ por nuk do me thënë që qytetari mundet me i marrë të njejtat nëse kryen shërbime më pak p.sh. i merr 110€. Përshejmë nëse i ka dërrasat në shtëpi pse duhet me i marrë paret, për mua kjo Rregullore është punu në mënyrë të kujdesshme.

Nazmi Krasniqi, kush është banor i Republikës së Kosovës i takon pagesa e jo dikujt nga shteti tjetër.

Daut Azemi, Kryesues i Kuvendit, sa për sqarim Arbeni tha se nëse një banor i Lipjanit ka dal në Ferizaj ai merr shërbime në Ferizaj po mundet me ardh edhe në Lipjan nëse e bëjmë pa fatur.

Arben Salihu, nëse ai i kryen shërbimet diku tjetër p.sh. Ferizaj, Prishtinë po hyjmë në kompetencat e dikujt tjetër pasi që Rregullorja po thotë për komunën e Lipjanit.

Afrim Miftari, kjo Rregullore mendoj se është punua mirë me disa vërejtje të minimizune, por ma esenciale është mirëmbajtja e varrezave nëpër fshatra pasi që është një gjendje jo e mirë e shpresojmë që në një të ardhme më të afërt të gjenë zbatim kjo Rregullore për mirëmbajtjen e varrezave nëpër fshatra, ku së paku nevojitet një rrethojë ose një person për mirëmbajtje të varrezave. Unë mendoj që të caktohet një kompani të merret me procedurat e varrimit si dhe procedura tjera.

Ramiz Qeriqi, Rregullorja është mirë, nuk mendoj që mundet me manipulu kërkush pasi që një hoxhë është ja e nënshkruar i Ferizajit ja i Lipjanit. Kjo Rregullore është e mirë pasi që deri tani janë keqpërdor ku ka një rast në Gjermani ku ka lyp sa kushton varrimi në Kosovë dhe një hoxhë të cilit nuk ja përmendi emrin ja ka marrë 3500€. Mendoj që kjo Rregullore është e mirë që po i shpëton të gjithë.

Ukë Kryeziu, unë mendoj që faturat nuk duhet të heqen por duhet të fillojnë edhe ato të tatimohen.

Naim Jahiri, ne edhe në Komitetin për Komunitete i kemi dhënë përkrahje dhe e përkrahim edhe tani.

Arben Salihu, Bashkësia Islame i ka 28 këshilla ku pjesë e BI jam edhe unë dhe nëse dikush ka fakte edhe unë ju ndihmoj por nëse edhe njëherë flisni unë do të ngris padi për shpifje.

Argjend Tasholli, kam një sqarim për lejen e varrimit e keni te neni 21 të Rregulores të ku duhet të merret leje për varrim e që te na më herët nuk e kemi marrë.

Avni Olluri, proceduralisht faturat nuk mund t'i heqim pasi që duhet të paguhet tatim. Po ashtu edhe thesari e kërkon momentin që rimbursohen mjetet. Nëse qytetari bjen fatur 150€ do të rimbursohet për 150€ e nëse bjen mbi 170€ do të paguhet vetëm për 170€.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim Rregulloren dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me të gjitha votat për aprovoi këtë:

Rregullore për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e tyre.

V

Propozim Vendim për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën, Avni Ollurit, drejtor i DA, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozim Rregullorja.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Meqë diskutime nuk pati rreth kësaj pike, Kryesuesi vuri në votim dhe pas votimit konstatoi, Kuvendi me 26 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR PËRCAKTIMIN E SHUMËS PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE PËR MBULIMIN E SHËRBIMEVE TË VARRIMIT

Neni 1

Me këtë Vendim **përcaktohet** që shuma për kryerjen e shërbimeve të Varrimit për qytetarët e Komunës së Lipjanit të jetë **170 €** për një varrim

Neni 2

1.Kjo shumë e mjeteve do të transferohet në xhirollogarinë bankare të anëtarit të familjes së ngushtë të të ndjerit/ës, i cili familjar duhet të parashtrojë kërkesë në Komunë brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e vdekjes.

2 .Procedurat rreth shërbimeve të varrimit, parashtrimit të kërkesës dhe dokumentacionit që duhet t' i bashkëngjitet kërkesës janë të përcaktuara me dispozitat e Rregullores për varrezat, ofrimin e shërbimeve të varrimit, rregullimin dhe mirëmbajtjen e varrezave 15Nr.011-71870 e datës; 27.11.2018.

Neni 3

Mjetet financiare për mbulimin e shërbimeve të varrimit do të paguhet nga buxheti i Komunës përkatësisht nga kategoria ekonomike e subvencioneve.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në fagen elektronike të Komunës dhe fillon të zbatohet nga data 01.01.2019.

Prej datës 01.01.2019 përkatësisht fillimit të zbatimit të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi për përcaktimin e shumës për ndarjen e mjeteve financiare Bashkësisë Islame në Lipjan për mbulimin e shpenzimeve të varrimit 15Nr.400-45612 i datës 12.11.2014.

Shtesë: Vendimi.

Pastaj Kryesuesi dha pauzë deri nga ora 12,³⁰ deri në 13,³⁰

VI

Informatë pune nga Drejtorati për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për periudhën Janar-Shtator 2018

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Vlora Limani-Hajnuni, drejtoreshë e DSHMS, e cila në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga Informata.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Shkelzen Bislimi, është një informatë deri diku e sakt, ku del me pak probleme edhe ato pak probleme ia kalon nivelit qëndror e ku dihet që edhe niveli qëndror e mbanë një përgjegjësi. Nuk respektohet orari i punës ku ka raste i gjithë stafi është në pauzë. Problem është edhe mungesa e auto ambulancave dhe veturave. Po ashtu të lindja është problem ku pacientet nuk kanë besim të bëjnë lindje në QKMF.

Ukë Kryeziu, ne si grup e kemi shqyrtu dhe e kemi analizu, këto janë specifiku të gjitha punët që i ka bërë drejtorati. Çasja jonë që çdo masë që merret ndaj pacientit na e përshëndesim. Unë do t'i ngris disa çështje por edhe disa probleme të cilat na shqetësojnë. Çështja organizative brenda QKMF-së po thuaj është e njejtë me përjashtim me disa sektor ai i sektorit të vaksionimit Naim Avdiut. Në informatën që na është dhënë këtë sektor e njeh si sektorë të suksesshëm. Ju kisha lut ta merrni parasysh këtë sektor të kujdeseni më shumë për këtë sektor. Problemet në emërgjencë duhet të ju qasni më shumë. Renovimi i QKMF-së po shihet që është bërë një punë e mirë por ka filluar në mars ende nuk është përfunduar. Blerja Kalldasë një investim i nevojshëm por a jini në dijeni se në QKMF problem i madh është dritare ku ka qenë një projekt i dështuar ku sa herë të bie shi hynë uji brenda dhe aty duhet të ketë një renovim. Në informatën e juaj përmendet edhe participimi i qytetarëve, a po ju kthehen këto pare qytetarëve. Po ashtu duhet të ju blehen edhe përparset(mantilat) mjekëve dhe stafit tjetër të cilët kanë mantila të ordinancave tjera ku vetëm në emërgjencë është gjendja pak më e mirë. Doktorëve ju mungojnë edhe elementet kryesore siqë janë tension matësi dhe stamoskafi.

Selatin Retkoceri, të gjitha qeverit nga pas lufta e kemi përmend shëndetësinë, arsimin dhe zhvillimin ekonomik. Sa i përket shëndetësisë ne duhet të bëjmë më shumë për shëndetësinë, duhet të ndajmë më shumë buxhet. Çështjet që i ka niveli lokal ka filluar të ecin mirë. Por duhet të shohim si ta funksionalizojmë maternitetin ku kemi vetëm 6 lindje, pse mos të ket më shumë. Nuk kemi nevojë për një prerje të gishtit apo diqka tjetër t'i dërgojmë në Prishtinë por duhet t'i aktivizojmë të gjitha njësitë. Viteve tjera duhet t'i kushtojmë më shumë rëndësi shëndetësisë dhe mjetet t'i dërgojmë në shëndetësi pasi që mundemi me nejtë pa drita nëpër fshatra, duhet të heqen disa prioritete tjera dhe mjetet të shkojnë në shëndetësi.

Lumturije Bytyqi-Hasani, shumica u përfshinë nga kolegët por kam një çështje për ta ngritë, është momografia e cila nuk punon çka do të bëhet me këtë, çështja tjetër është ekipa e patronazhit ku Lipjani është e vetmja në Kosovë që nuk ka ekip të patronazhit, është mirë me fillu procedurat për funksionalizimin e ekipit të patronazhit. Çështja tjetër ka të bëjë me punën e laborantit në Janjevë aty punëtorët shkojnë me rotacion është mirë të bëhet një zgjidhje më afatëgjatë, të hapet një konkurs pasi që është e pa drejtë punëtorët me i dërgu p.sh. prej Shales me rotacion në Janjevë.

Nazmi Krasniqi, në QKMF janë bërë disa renovime por këto ditë unë kam qenë aty dhe për prerjen e gishtit nuk ka pasur fashë, vazolinë dhe u detyrova me shku në Prishtinë ku ata u quditën se si nuk ka në Lipjan. Po ashtu shërbimi i barnatorës thojnë se nuk kemi barna pasi që nuk na kanë nda ende buxhet. E kam një pyetje se sa janë funksionale aparatet brenda QKMF-së.

Hyra Bytyçi, në emër të grupit parlamentar të LDK-së dhe PD-se e falënderoj drejtoreshën për informatën ku është arritur progres falë prioriteteve për shëndetësi dhe përkujdesje sociale që i ka parapri Kryetari i Komunës Imri Ahmeti duke emëruar Vlora Limanin-Hajnuni si drejtoreshë e cila ofroi një qasje proaktive rreth menagjimit të objektivave kryesore për ofrimin e shërbimeve efikase dhe efektive. Gjithashtu e vlerësojmë lartë bashkëpunimi me donatorë të ndryshëm dhe OJQ të cilat përpos që e kanë mbështetur me paisje shëndetësore shëndetësinë kanë orfruar edhe trajnime të ndryshme për stafin shëndetësor, mirëpo shëndetësia mbetet ende sfidë dhe shqetësim për ne. Ne e inkurajojmë që edhe për kundër kufizimeve buxhetore të vazhdohet më tutje të gjenden rrugë dhe alternativa tjera të cilat mund të ndikonin në përmirësimin e shëndetësisë. E gjitha kjo arrihet me punë dhe bashkëpunim andaj mos ta harrojmë që shëndeti është mbi të gjitha.

Arben Salihu, kur po flitet për asfaltimin dhe ndriçimin sikur po ju bëhet një ofendim banorëve të fshatrave mjafton të dalim të shohim gjendjen e tyre nëpër fshatra.

Lulzim Rustemi, një informatë e mangët ku drejtorati për shëndetësi duhet të bëjë më shumë për shëndetin e qytetarëve, ka për obligim të kujdeset për kategoritë sociale, veteranët ka nevojë të kujdeset për strehimin e atyre që kanë nevojë për strehim. Na nuk kemi informatë se cila është gjendja momentale e QMF-ve, AMF-ve, si respektohet orari në to. Nuk e dijmë se sa është funksionale aparatura në to, nuk e dijmë se cilat AMF nuk funksionojnë fare. Kemi edhe fushata senzibilizuese të cilat janë të mira, mirëpo QKMF-ja angazhon OJQ që nuk kanë të bëjnë me shëndetësi ato e marrin një mjek dhe al bënë fushatë në tërë Lipjanin. Si funksionon drejtorati i shëndetësisë së bashku me sektorët që i ka a ka staf profesional në të. Kjo informatë nuk është profesionale më tepër është përshkruese, ka shumë ende për t'u bërë për shëndetësi.

Vlora Limani-Hajnuni, sa i përket ridestinimit ka pasur një kërkesë në Kuvend dhe ju e keni votu. Ndërsa projekti i AQH-së ata i menagojnë të gjithë projektin, unë e kam kërkuar një informacion nga ta. Komuna e Lipjanit aplikon në donacionet e ndryshme dhe ka përfutur këtë herë nga AQH-ja.

Vlerësimi profesional shëndetësor është një projekt që unë e kam kërkuar dhe te qytetarët ka ndikuar mirë.

Te respektimi i orarit të punës nëse ka ndonjë përsos që del në pauzë dhe nuk kthehet përsëri ju kisha lutë ju që i dini me emëra më tregoni. Pasi që unë para dy jave kam

marrë një vendim që duhet të respektohet orari i punës në QKMF, dhe punëtorët që nuk do të gjinden në orar të punës ndaj tyre do të merren masa. Shëndetësia nëpër komuna është në këtë gjendje pasi që shteti asnjë herë nuk e ka marrë me seriozitet punën e shëndetësisë. Është një informatë e sakt për punën e drejtoratit të shëndetësisë, por mund të ketë edhe mangësi. Furnizimi me barrna është përgjegjësi i Ministrisë së shëndetësisë dhe ne si komunë nuk guxojmë t'i blejmë. vet barrnat p.sh. siqë është insulina dhe vaksina për shkak të specifikacitetit që ka. Por ne kemi lidhur kontrata kornizë për barrna më esenciale. Ministria i ka ndarë 138 mijë euro dhe e ka marrë për barrë funksionalizimin e SISH-it, mirëpo nuk i ka aloku mjetet. Maternitetin e kemi planifiku në projekt buxhetin e vitit të ardhshëm po ashtu. Po ashtu në projekt buxhet e kemi edhe një auto ambulancë dhe një auto kombi. Sa i përket paisjeve mjekësore disa janë funksionale, ndërsa mamografi nuk është funksional pasi që është defekt në paisje dhe për këtë është vetëm një kompani e cila mund ta rregulloj. Laboratori do të zbres poshtë për të ju lehtësuar qytetarëve. Në vitin e ardhshëm presim t'i rrisim furnizimet me material shpenzues, stamatologjik, mjekësorë etj.

Ukë Kryeziu, pa dyshim se orari i punës po respektohet por momentin që e shoh që nuk po respektohet unë do ju njoftoj, ndërsa sa i përket mamografisë nuk është mirë me thënë që duhet të bëhet vetëm në raste të veçanta mamografia. Ndërsa unë nuk e di që ka në QKMF një shef që i ka vetëm dy punëtorë.

Nehat Tërpeza, deshta me pyet për insulinën sa ekziston mundësia që ato të shpërndahen nëpër AMF në mënyrë që të ju lehtësohet qytetarëve dhe stafit të QKMF-së.

Nazmi Krasniqi, fashën vazolide a ka mundësi me e siguru. Pse drejtori që ka qenë nuk e kryen detyrën e mëhershme.

Naim Jahiri, unë si qytetarë dhe si anëtarë i Kuvendit sa herë që shkoj në QKMF kryej shërbim, dhe falenderoj shumë drejtoreshën për këtë informatë.

Lumturije Bytyqi-Hasani, në QKMF ka filluar me numra po ju njoftoj pasi që drejtoresha se ka përfshi në informatë, ndërsa sa i përket kontributit në Kuvend unë edhe më herët e kam përmend gjendjen në stamatologji, emërgjencë dhe ne kërkesat i kemi bërë ku janë edhe procesverbalet.

Albulena Kelmendi, kam dy çështje kontrollat sistematike nëpër shkolla a bëhen, çështja e dytë mua para disa dite përshtet më ka ndodhur të shkoj në QKMF në ordinancën aty ku presin Lipjani dhe diku në ora 5-6, nuk e di a praktikanë apo infermiere kishin lëshuar muzikë me që të lartë dhe m'u duk jo serioze pasi që njerëzit aty shkojnë prej zorit.

Vlora Limani-Hajnuni, unë nuk kam hasur në raste të tilla të cilat i përmendi Albulena dhe unë e kam ndryshuar casjen e personelit në QKMF. Sa i përket praktikantëve na obligon Ligji me pasur praktikant dhe ata do të jenë nga 2 orë në ditë, ndërsa në emërgjencë pas orës 8 nuk do të ketë praktikant. Sa i përket fashat me vazolinë janë. Sa i përket stamatologjisë kam marrë informatë nga shefi i sektorit se për shërbime më të thjeshta pacientët nuk kthehen siqë është heqja e dhëmbit. Emërgjencën po mundohemi ta funksionalizojmë recepcionin ku pacienti të marrë udhëzimin kahë të shkoj. Fushata e vaksinimit në këtë vit ka filluar.

Meqë diskutime tjera nuk pati rreth kësaj pike, u kalua në pikën e gjashtë të rendit të ditës

VII

Propozim Vendim për formimin e Komisionit komunal të aksionarëve

Lidhur me këtë pikë, Kryesuesi i Kuvendit Daut Azemi, i dha fjalën Ilir Tashollit, drejtor i DSHP, i cili në vazhdim i njoftoi të pranishmit me të dhënat nga propozimi i vendimit.

Pastaj Kryesuesi hapi diskutimin?

Majlinda Sylejmani, tha se për anëtarë të komisionit e propozojmë Anila Reçica-Llugiqi.

Lulzim Rrustemi, tha se ne për anëtarë të komisionit e propozojmë Nazmi Krasniqin.

Meqë diskutime tjera rreth kësaj pike nuk pati Kryesuesi vuri në votim propozim e vendimit dhe pas votimit Kuvendi konstatoi se me 26 vota për, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL TË AKSIONARËVE

Neni 1

Formohet Komisioni Komunal i Aksionarëve në Ndërmarrjen Publike Lokale “Pastrimi” (në vazhdim të tekstit Komisioni) në përbërje si vijon :

1. Ilir Tasholli, anëtar i emëruar nga Kryetari i Komunës,
2. Anila Reçica-Llugiqi, anëtare e emëruar nga Kuvendi i Komunës dhe
3. Nazmi Krasniqi, anëtar i emëruar nga Kuvendi i Komunës.

Neni 2

Komisioni do të veprojë në emër të Komunës dhe në përputhje me dispozitat e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Komisioni i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve do t'i raportojë Kuvendit Komunal në bazë vjetore mbi performancën e këtyre kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara në politikën e pronësisë të përcaktuar në nenin 6.2 të Ligjit për Ndërmarrjet publike. Komisioni do t'i sigurojë të dhëna

kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të Ndërmarrjes publike lokale në interes të Komunës.

Neni 3

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi shfuqizohet Vendimi Nr. 15Nr.334-40369 i datës 29.09.2014 për formimin e komisionit komunal të aksionarëve.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në Webfaqen e Komunës.

Pasi çështje të tjera nuk pati mbleldhja përfundoi në ora 15,¹⁵

Ekstraktin e hartoi
Behar Aliu

Kryesuesi i Kuvendit
Daut Azemi